



Zyra Evropiane e Radiokomunikacioneve



Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë  
Prezenca në Shqipëri

## **Komente për projektin e Strategjisë së Zhvillimit të Transmetimeve Numerike në Republikën e Shqipërisë**

21 shtator 2004

### **Hyrje**

Në një letër të datës 7 shtator 2004, Zëvendëskryetari i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT), organizmi kombëtar i rregullimit të transmetimeve radiotelevizive, kërkoi mendimin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri për Projektstrategjinë për Zhvillimin e Transmetimeve Televizive Numerike në Republikën e Shqipërisë, përgatitur nga KKRT-ja, më 11 maj 2004.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, në bashkëpunim me Zyrën Evropiane të Radiokomunikacioneve (ERO), ka përgatitur komente dhe propozime të përbashkëta për projektstrategjinë. Këto sugjerime praktike marrin në konsideratë përpjekjet që po bëhen aktualisht në një kontekst më të gjerë evropian e ndërkombëtar për kalimin në transmetimin numerik tokësor.

Siç theksoi Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias në letërën e tij drejtuar Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, më 10 shtator 2004, transmetimet numerike tokësore shihen si e ardhmja e industrisë së transmetimeve televizive, por kjo është një teknologji e re, që sapo ka filluar të zbatohet në Evropë. Për këtë arsye, ajo duhet trajtuar me kujdes dhe jo nën presion. Përfaqësuesi i OSBE-së dhe Prezenca, si dhe ERO, e konsiderojnë këtë proces shumë të rëndësishëm për të ardhmen e medias elektronike në Shqipëri dhe për procesin e integritetit evropian të vendit. Në këtë kontekst, është shumë e rëndësishme që futja e transmetimeve numerike tokësore të bëhet pas një studimi të kujdesshëm.

### **Komente të përgjithshme:**

1. Në shikim të parë, duket e çuditshme që Shqipëria po ndërmerr një strategji për futjen e menjëhershme të televizionit numerik në fazën kur nuk është normalizuar ende as përdorimi i bandave televizive nga kanalet analoge. Fakti që deri tani bandat televizive në

Shqipëri janë të mbingarkuara me shumë kanale televizive, të cilat transmetojnë në kundërshtim me praktikën e mira të inxhinierisë së radios dhe administrimit të spektrit, tregon se gjendja do të ndërlikohej edhe më shumë pas futjes së televizionit numerik.

2. Megjithëse nisma për planifikimin e televizionit numerik dhe për përgatitjen e planeve për të ardhmen është një veprimtari për t'u përshëndetur, ajo duhet të trajtohet pa presionin dhe ngutjen e futjes së imponuar e të menjëhershme të televizionit numerik. Përvoja e vendeve të tjera në Evropën Perëndimore dhe Lindore tregon që mund të duhen 5-10 vjet që nga fillimi i punës për planin deri në vënien në punë të sistemeve të mirëfillta.
3. Duket se shtesa e fshehtë, por gjithsesi e vërtetë, për futjen e menjëhershme të televizionit numerik në Shqipëri është dëshira për të ofruar shërbime televizive me pajtim, dhe kjo, në vetvete, është një dëshirë e natyrshme dhe e respektuar, veçanërisht, në situatën ku rrjetet televizive kabllorë nuk janë të zhvilluara, dhe, rrjedhimisht, rrjetet e bazuara në teknologjinë e radios mund të ofrojnë një zgjidhje të zbatueshme për arritjen e shpejtë të mbulimit të nevojshëm. Gjithsesi, këto shërbime televizive me pajtim mund të ofrohen lehtësisht edhe përmes teknologjive të tjera të radios përveç televizionit numerik, si, për shembull, duke ngritur të ashtuquajturin MMDS (Shërbimi i Shpërndarjes Shumëkanalësh dhe Shumëpikësh), i cili quhet ndonjëherë edhe “televizioni kabllor pa kabëll”. Ky sistem funksionon në banda të posaçme, pra, jashtë bandave televizive, prandaj ngritja e tij nuk do të ngarkonte më tej shërbimet televizive analoge ekzistuese dhe do të lejonte futjen graduale të televizionit numerik në kohën e duhur. Kjo gjë përshkruhet më me detaje në pjesën e Propozimeve më poshtë.

#### **Komente për pika të veçanta në dokumentin e strategjisë:**

1. Strategjia bën fjalë për mbulimin e territorit të Republikës, megjithatë, në realitet, planifikimi duhet të bazohet në mbulimin e “popullsisë”, pra rrjetet duhet të planifikohen rreth qyteteve, në vend që të ofrojnë mbulim të të gjithë territorit, gjë që mund të përfshijë në mënyrë të panevojshme mbulimin e shumë zonave thuajse të pabanuara;
2. Strategjia i referohet respektimit të “standardeve të Bashkimit Evropian”, por BE-ja nuk ka standarde për planifikimin teknik të televizionit numerik. Në fakt, strategjia duhet t'i referohet respektimit të “dokumenteve të politikave të BE-së dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, përfshirë dispozitat e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU), si dhe dokumentet e marrëveshjet e Konferencës Evropiane të Administratave të Postë-Telekomunikacioneve (CEPT)”;
3. Strategjia i referohet marrëveshjes së Chester-it si “dokumenti bazë për standardizimin e planifikimit të transmetimeve numerike tokësore”, gjithsesi, ajo marrëveshje ishte veçse një udhërrëfyes i përkohshëm, i cili tani po zëvendësohet nga veprimtaritë për rishikimin e marrëveshjes së Stokholmit të vitit 1961 në kuadrin e Konferencës Rajonale të Radiokomunikacioneve të ITU-së (KRR), seanca e parë e së cilës u mbajt në vitin 2004, ndërsa seanca përfundimtare do të mbahet në vitin 2006;
4. Strategjia përcakton më parë llojin e rrjetit (SFN kundrejt MFN) dhe, më pas, e lidh atë me nivelin kombëtar ose rajonal të shpërndarjes. Në fakt, duhet të merret në konsideratë

mbulimi i dëshiruar specifik i rrjetit, i cili do të diktonte më pas llojin e rrjetit që do të duhej të përdoret në mënyrë që ky mbulim të bëhet në mënyrë sa më efektive. Gjithashtu, nocioni i rrjeteve të ndashme kundrejt rrjeteve të pandashme është përdorur në mënyrë të papërshtatshme. I tërë diskutimi për modelet e rrjeteve televizive numerike në pjesën 4.4 është tejtejt i thjeshtëzuar.

5. Diskutimi për numrin e realizueshëm të rrjeteve /programeve numerike në pjesën 4.6.1. duket i paqartë dhe numri i parashikuar i rrjeteve (21 në nivel kombëtar) duket jorealistic. Për krahasim, provat aktuale të planifikimit në vende të tjera evropiane mbështeten në mendimin se, normalisht, mund të realizohen deri në gjashtë, maksimumi dhjetë rrjete, edhe për vende të mëdha si Gjermania;
6. Nuk përshkruhet qartë se çfarë lloj procedure licencimi do të ndiqej (konkurs mbi bazën e meritave, ankande?), ndërkohë që ky është një element shumë kritik dhe delikat në aspektin politik;
7. Skenaret për kalimin në transmetimin numerik në pjesën 7, me sa duket, janë marrë nga dokumentet e ITU-së, të përgatitura në fazën përgatitore të sesionit të vitit 2004 të KRR-së. Aty, sidoqoftë, këto skenare u zhvilluan në kontekstin e krijimit të një plani të ri frekuencash numerike dhe, për këtë arsye, ato nuk duhen përdorur drejtpërdrejt në kontekstin e “shndërrimit në sistem numerik”. Ky i fundit është një proces shumë më kompleks, që përfshin shumë çështje joteknike (ligjore, politike, ekonomike), të cilat varen nga veçoritë e çdo vendi, por që u lanë jashtë diskutimit pikërisht për këtë arsye;
8. Ka disa gabime në këto skenare, si për shembull, hipoteza se nuk do të ekzistonte nevoja për marrëveshje ndërkombëtare në skenarin 1. Gjithashtu, lista e çështjeve për shqyrtimin e dates së mbylljes së televizionit analog në pjesën 7.7. nuk përmend dy prej disa prej pikave më të rëndësishme, veçanërisht, mbulimin e realizuar të televizionit numerik dhe futjen e marrësve të televizionit numerik në tregun e konsumatorëve;
9. Si një koment që vlen për gjithë dokumentin, mund të sugjerohet që aspektet e administrimit të spektrit të planit për televizionin numerik duhet të ndahen nga shqyrtimet për “furnizimin me programe”, pasi këto janë dy çështje të ndryshme.

### **Propozime:**

Mund të rekomandohet që KKRT-ja të vazhdojë të punojë më tej për zhvillimin e strategjise për futjen e televizionit numerik në Shqipëri dhe, në këtë mënyrë, të marrë pjesë aktive në aktivitetet evropiane të planifikimit. Koha e futjes së planifikuar të televizionit numerik nuk duhet caktuar që tani. Ajo duhet të përcaktohet vetëm pas përfundimit të planifikimit.

Ndërkohë, për të lehtësuar presionin për ofrimin e shërbimeve të shpërndarjes së programeve televizive me pajtim, mund të merren në konsideratë dy alternativat e mëposhtme:

1. Të jepen një apo dy licenca provë për televizionin numerik në Tiranë dhe ndoshta edhe në, për shembull, dy qendra të tjera të mëdha urbane. Kjo mund të justifikohet me nevojën e testimit të pajisjeve, fitimit të përvojës së vërtetë të tregut, etj. Sidoqoftë, në mënyrë që ky eksperiment të ketë përpjesëtime të arsyeshme, numri i këtyre licencave provë dhe mbulimi i tyre duhet të jetë i kufizuar, si rrjedhojë, pyetja që ngrihet është nëse

KKRT-ja do të ishte në gjendje të kontrollonte situatën, në rast se kërkesa për shërbime të reja do të rezultonte e lartë. Kohëzgjatja e këtyre licencave provë mund të jetë ose rreth pesë vjet, ose “derisa të përfundojë plani dhe të jepen licencat e rregullta”. Në rastin e dytë, do të ishte e natyrshme që operatorët që zotëronin licenca provë të kishin fituar përvojë dhe treg të mjaftueshëm për të konkurruar dhe për të marrë licencat e “rregullta”, në mënyrë që investimet e tyre fillestare të mos shkonin dëm.

2. Një variant i mundshëm, i përballueshëm dhe i mirë teknikisht do të ishte dhënia e licencave për ofrimin e shërbimeve të shpërndarjes së programeve televizive me pajtim, duke përdorur teknologjinë MMDS, për shembull, në bandën 2500-2690 MHz. Rrjetet MMDS në këtë bandë janë përdorur gjerësisht në Amerikë (veçanërisht në SHBA) dhe, që në fillim të viteve 90, në shumë vende të Evropës Lindore, por edhe në disa vende të Evropës Perëndimore. Një përdorim kaq i gjerë do të thotë se çmimet e pajisjeve duhet të jenë mjaftueshmërisht të ulta dhe niveli i shërbimeve të ofruara i kënaqshëm. Normalisht, rrjete të tilla lejojnë shpërndarjen e sigurt (analog dhe numerik të përzier) të rreth 24 kanaleve televizive të shumë pajtimtarë. Banda e frekuencës 2,5 GHz do të ishte ideale për praktikën shqiptare të ofrimit të shërbimit për qytetet nga majat e maleve afër tyre, pasi do të kishte mundësi të mira për një vijë të drejtpërdrejtë shikimi me stacionin bazë. Së fundi, prodhuesit ofrojnë edhe pajisje MMDS me një kanal të dedikuar kthimi, që lejon ofrimin e shërbimeve ndërvepruese, si përdorimi i Internetit. Gjithashtu, mund të përdoren edhe banda të tjera përveç bandës së sipërpërmendur 2,5 GHz për shërbime si MMDS, megjithëse çmimet e pajisjeve janë disi më të larta në këto banda të tjera. Duhet përmendur se banda 2500-2690 MHz është përcaktuar në Evropë për shtrirjen e ardhshme të rrjeteve të lëvizshme të telekomunikacionit 3G/UMTS. Gjithsesi, rrjetet UMTS duhet të zhvillojnë fillimisht banda të tjera parësore, kështu që, mund të sugjerohet që, në Shqipëri, të përdoret banda 2,5 GHz për MMDS-në për afate të shkurtra deri të mesme (5-10 vjet), për shembull, deri sa televizioni numerik të jetë planifikuar dhe zhvilluar siç duhet ose deri sa baza e pajtimtarëve dhe aftësia e tyre blerëse të jenë zhvilluar për të justifikuar marrjen pa kabëll dhe rrjetet televizive të shpërndarjes në banda me frekuenca më të larta (p.sh. 3,5 GHz, 10 GHz, 26 GHz.)

Gjithashtu, mund të thuhet se të dyja këto variante mund të ushtrohen paralelisht, në qoftë se kërkesa për rrjete shpërndarëse të programeve televizive me pajtim rezulton të jetë e lartë.